



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-146

Prishtinë, më 24 shkurt 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 SHKURT 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamit dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shkurt 2014,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shkurt 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shkurt 2014.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet më 27 shkurt 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dh Qeverisë së Republikës së Kosovës*
5. *Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014,*
6. *Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikate,*
10. *Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovës,*
11. *Debat parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë,*
12. *Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK "Ballkan" në Suharekë,*
13. *Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarit në*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Iniciativa qytetare për fillimin e nismës ligjore për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryesia u njoftua lidhur me iniciativën qytetare për fillimin e nismës ligjore për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

2. Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për radhitjen në shqyrtim të dytë në seancë plenare të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Kryesia, pas diskutimit lidhur me kërkesën e lartpërmendur, nxori këtë:

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim që ta shqyrtojnë Projektligjin me amendamentet e propozuara dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesin raportin me rekomandime më së largu deri më 10 mars 2014, në të kundërtën projektligji do të radhitet për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

3. Kërkesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Luftëtarëve të UÇK-së

Kryesia pas diskutimit për pikën e lartpërmendur konstatoi që Projektligjin për veteranët e UÇK-së deri në shqyrtim të parë të procedohet sipas rregulltave procedurale, ndërsa gjatë shqyrtimit të dytë komisionet parlamentare ta përshpejtojnë shqyrtimin e tij.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale